



Prishtinë, 24 qershor 2008
Kodi i ZRRE-së: D_108_2008

Bordi i Zyrës së rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 11 të Licencë për Gjenerim të energjisë elektrike-TC Kosova A.
3. Dispozitat e Nenit 11 të Licencë për Gjenerim të energjisë elektrike-TC Kosova B.
4. Kërkesën me shkrim të KEK Sh.A -së të dërguar në ZRRE me datë 11 prill 2008, në seancën e mbajtur me datë 24 qershor 2008, nxori këtë:

VENDIM

APROVOHET kërkesa e KEK SH.A-së- (TC Kosova A dhe TC Kosova B) për emërimin e ekspertëve të pavarur

1. Sipas Nenit 11 licencës së KEK Sh.A-Divizioni i Gjenerimi -TC Kosova A dhe TC Kosova B kanë për obligim të caktojnë ekspert të pavarur, emërimi të cilëve duhet të bëhet nga Bordi i ZRRE-së.
2. Bordi i ZRRE-së pas shqyrtimit të kërkesës së KEK SH.A-së të dorëzuar në ZRRE me datë 11 prill 2008, dhe vlerësimit të biografisë së kandidatëve të cilët do të bëjnë kontrollin teknik dhe të sigurisë së kapaciteteve prodhuese, ka aprovuar që:

Z. Behxhet Maxhuni – të jetë ekspert i pavarur për njësinë gjeneruese TC Kosova A.

Z. Xhemajl Gërguri – të jetë ekspert i pavarur për njësinë gjeneruese TC Kosova B

3. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
4. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit ose në datën e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së

Bashkëngjitur: Biografia e Z. Behxhet Maxhuni dhe Z. Xhemajl Gërguri

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Dr.Nysret Avdiu, Anëtar

Mr.Theranda Beqiri, Anëtare